

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA FOOTBALL
FEDERATION OF KOSOVA



PROPOZICIONET E GARAVE
Për Superligën, Ligën e Parë dhe Ligën U-17 vajza/gra
Kampionati i Kosovës në Futboll 2023 - 2024

Prishtinë, Gusht 2023

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës miratoi plotësimet dhe ndryshimet bazuar në Nenin 2, pika c), g) dhe m), Nenin 41, pika c) dhe n), Nenin 49, Nenin 77 të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës, të miratuar më 27.01.2023, dhe në mbledhjen e vet të mbajtur më 18 Gusht 2023, aprovon:

PROPOZICIONET E GARAVE

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Propozicione, caktohet mënyra, organizimi dhe udhëheqja e garave të kampionatit të futbollit të vajzave/grave në Kosovë për rangjet garuese; Superliga, Liga e parë dhe Liga e Kadeteve U-17.

Neni 2

Me garat e futbollit në rangjet Superliga, Liga e Parë dhe Liga e Kadetëve U17 – vajzave/grave, udhëheqen nga Komisioni i Garave të vajzave/ grave, të njejtin e emëron dhe shkarkon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

II. SISTEMI I GARAVE

Neni 3

Garat kampionale të futbollit të vajzave/grave për Superligë, Ligën e Parë, dhe Ligën e Kadeteve U-17, do të zhvillohen sipas sistemit të Garave, në të cilën do të marrin pjesë:

3.1 Superliga/ Senioret – garon me 8 ekipe

Nr.	SUPERLIGA: vajza/gra	Selia
1	KFF EP Hajvalia	Hajvali
2	KFF Mitrovica	Mitrovicë
3	KFF Kosova VR	Prishtinë
4	KFF Malisheva	Malishevë
5	KFF Llapi	Podujevë
6	KFF Dukagjini	Klinë
7	KFF Bazeli 2015	Kaqanik
8	SHF Presingu	Viti

Superliga Senoret: vajza/gra zhvillohen nga 21 xhiro të rregullta prej të cilave; 11 në stinorin vjeshtor dhe 10 në stinorin pranveror, gjithësej zhvillohen 84 ndeshje të rregullta zyrtare (kampionale).

Sistemi i garave në **Superligën** e futbollit të vajzave/grave do të zhvillohet në tri etapa sipas sistemit të Bergerit, pra do të zhvillohen gjithsej 21 xhiro prej të cilave 11 xhiro në stinorin vjeshtor dhe 10 xhiro në stinorin pranveror.

Bazuar në sistemin e Bergerit në dy etapat e para janë të përcaktuara ekipet vendase dhe ekipet mysafire, ndërsa për etapën e tretë të zhvillimit të ndeshjeve vendasi do të përcaktohet sipas këtyre kritereve, të cilat do të zbatohen pas përfundimit të etapës së dytë me saktësisht pas xhiros së 14-të;

- a) Rezultati i ndeshjeve të ndërsjellta;
- b) Ekipi që është i ndëshkuar me më pak kartona të kuq gjatë Kampionatit;
- c) Ekipi që është i ndëshkuar me më pak kartona të verdhë gjatë Kampionatit;
Nëse edhe në këto raste pikët janë të njejta atëherë merret parasysht:
- d) Shorti

3.2 Liga e Parë/ Senoret – garon me 8 ekipe

Nr.	Liga e parë: vajza/gra	Selia
1	KFF Vizioni	Ferizaj
2	KFF Liria	Prizren
3	KFF Jakova	Gjakovë
4	KFF Intelektualet	Gjilan
5	KFF Feronikeli	Drenas
6	KFF 16 Qershori	Malishevë
7	KFV Prishtina	Prishtinë
8	KFF Ulpiana	Lipjan

Liga e Parë- Senoret: vajza/gra zhvillohen nga 21 xhiro të rregullta prej të cilave; 11 në stinorin vjeshtor dhe 10 në stinorin pranveror, gjithësej zhvillohen 84 ndeshje të rregullta zyrtare (kampionale).

Sistemi i garave në **Ligën e Parë** të futbollit të vajzave/grave, do zhvillohet në tri etapa sipas sistemit të Bergerit.

Bazuar në sistemin e Bergerit në dy etapat e para janë të përcaktuara ekipet vendase dhe ekipet mysafire, ndërsa për etapën e tretë të zhvillimit të ndeshjeve vendasi do të përcaktohet sipas këtyre kritereve, të cilat do të zbatohen pas përfundimit të etapës së dytë me saktësisht pas xhiros së 14-të;

- a) Rezultati i ndeshjeve të ndërsjellta;
- b) Ekipi që është i ndëshkuar me më pak kartona të kuq gjatë Kampionatit;
- c) Ekipi që është i ndëshkuar me më pak kartona të verdhë gjatë Kampionatit;
Nëse edhe në këto raste pikët janë të njejta atëherë merret parasysht:
- d) Shorti

Ndërsa ekipi që fiton më së paku pikë përgjatë 21 xhirove të rregullta të Superligës, do të kalojë në rang më të ulët – Ligën e Parë të Kosovës në futboll/vajzat (vendi i 8-të), kurse ekipi i plasuar në vendin e 7-të, do të luaj ndeshjen e barazhit me vendin e 2-të të Ligës së Parë, për ruajtjen apo fituesin e statusit në Superligë për edicionin vijues 2024-2025.

Ndeshja do të zhvillohet në terren neutral (e cakton KE i FFK-së). Nëse ndeshja kryhet barazi vijojnë vazhdimet 2 x 15 minuta, dhe nëse edhe atëherë nuk ka fitues ekzekutohen penalltitë.

Fituesi nga kjo ndeshje fiton statusin e anëtarit të Superligës për edicionin 2024-2025.

Ekipi që fiton më së shumti pikë (vendin e parë), në Ligën e Parë (duke i mbledhur pikët e 21 xhirove të zhvilluara – rregullta, e fiton të drejtën për të kaluar në rang më të lartë – në Superligë.

3.3 Liga U-17 (Vajzat) - numri ekipeve garuese (të paraqitura); 20 ekipe

Nr.	Ekipet; U-17 vajzat	Selia
1	KFF Mitrovica	Mitrovicë
2	KFF Dukagjini	Klinë
3	KFF Kosova VR	Prishtinë
4	KFF Ep Hajvalia	Hajvali
5	KFF Malisheva	Malishevë
6	SHF Presingu	Viti
7	KFF Llapi	Podujevë
8	KFF Shqiponja	Malishevë
9	KFF Intelektualet	Gjilan
10	KFF Bazeli 2015	Kaçanik
11	KFF 16 Qershori	Kijevë
12	KFF Istogu	Istog
13	KFF Ardhmëria	Obiliq
14	KFV Prishtina	Prishtinë
15	KFF 2 Korriku	Prishtinë
16	KFF Jakova	Gjakovë
17	KFF Behar	Vitomicë
18	KF Ferizaji	Ferizaj
19	KFF Deçani	Deçan
20	KFF Feronikeli	Drenas

Liga U-17 përbëhet prej 20 ekipeve të ndara në dy grupe:

a) Grupi A, me 11 ekipe garuese - Rajoni (Prishtinë – Gjiilan – Ferizaj).

Ekipet garuese të Grupit A:

- KFF Kosova VR,
- KFF Prishtina
- KFF Ep Hajvalia,
- KFF Presingu,
- KFF Llapi,
- KFF Intelektualet,
- KFF KArdhmëria,
- KFF 2 Korriku,
- KFF Bazeli 2015.
- KFF Ferizaji

b) Grupi B, me 10 ekipe garuese - Rajoni (Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren).

Ekipet garuese të Grupit B:

- KFF Mitrovica,
- KFF Dukagjini,
- KFF KMalisheva,
- KFF Shqiponja,
- KFF K16 Qershori,
- KFF Istogu,
- KFF Jakova,
- KFF Behar
- KFF Deçani
- KFF Feronikeli

Liga e vajza/grave U-17 organizohet me sistem të zhvillimit të ndeshjeve: vajtje – ardhje për xhirot e rregullta (vjeshtë dhe pranverë). Dhe play-off në fund të kampionatit.

Në Grupin A, do të zhvillohen 18 xhiro, vajtje - ardhje sipas sistemit të Bergerit, prej tyre 9 xhiro në stinorin vjeshtor si dhe 9 xhiro në stinorin pranveror, gjithësej zhvillohen 90 ndeshje të rregullta zyrtare (kampionale).

Në Grupin B, do të zhvillohen 18 xhiro, vajtje - ardhje sipas sistemit të Bergerit, prej tyre 9 xhiro në stinorin vjeshtor si dhe 9 xhiro në stinorin pranveror, gjithësej zhvillohen 90 ndeshje të rregullta zyrtare (kampionale).

VËRTETIMI I PLASMANIT për ligën U17 vajzat pas 18 xhirove të zhvilluara, bazohet në nenin 68 të Propozicioneve të Garave Unike.

Në fund të Kampionatit do të zhvillohet Play Off, ku ekipi që në fund të sezonit përfundon në vend të parë të grupit A do të luaj kundër vendit të dytë të grupit B, dhe vendi i parë i grupit B do të luaj kundër vendit të dytë të grupit A. Fituesit e këtyre dy çifteve do të luajnë një ndeshje finale, nga e cila do të përcaktohet ekipi kampion.

Garat e U-17 për futbollin e vajzave janë plotësisht të pavarura nga garat e senioreve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short.

III. KALENDARI I GARËS

Neni 4

4.1 Datat dhe oraret e ndeshjeve – Datat dhe oraret e zhvillimit të ndeshjeve do të përcaktohen nga klubet vendase, më së voni tre ditë para zhvillimit të ndeshjes të cilat obligohen t'i caktojnë në vikend, me miratimin e Komisionit të Garave.

4.2 Koha e zhvillimit të ndeshjeve – Të gjitha ndeshjet që do të zhvillohen në kuadër të Kampionatit, Kupës, nuk mund të caktohen të zhvillohen para orës 11:00. Ky orar vlen për të gjitha kategoritë (Superliga, Liga e Parë dhe Liga U 17, garat kampionale dhe ato të Kup-ës).

4.3 Mbërrtija e ekipeve - Ekipet pjesëmarrëse duhet të paraqiten në stadiumin ku është parashikuar të zhvillohet ndeshja të pakten 60 minuta para orarit të përcaktuar për fillimin e ndeshjes.

4.6 Shtyrja e ndeshjes - Nëse për shkaqe objektive zhvillimi i një ndeshjeje vihet në dyshim, ekipi vendas duhet menjëherë të njoftojë FFK-në. Kjo e fundit, vendos nëse ndeshja duhet të zhvillohet sipas parashikimit apo duhen bërë ndryshime në datën, orën apo vendin. Këto vendime janë të formës së prerë.

Nëse ekipi i jep dy ose më tepër lojtare për Përfaqësuesen e Kosovës (kombëtaren), për të zhvilluar ndeshjen e paraparë me kalendar të garave, atëherë kërkesa e tij mund të ndryshojë orarin e zhvillimit të ndeshjes kampionale apo për kupë.

Ndeshja mund të shtyhet për shkak të pjesëmarrjes së klubeve në garat ndërkombëtare, dhe për shkaqe të sigurisë. Ndeshjet e shtyra do të luhen menjëherë në terminin e parë të lirë, dhe këtë vendim e merr organi kompetent i garave (Komisioni Organizativ i garave).

Organi që udhëheq me gara, mund të marrë vendim mbi shtyrjen e ndeshjes konform dispozitave të paragrafit paraprak dhe ka për obligim t'i njoftojë me shkrim apo me emal zyrtar ekipet e interesuara, dhe atë më së voni tre ditë para terminin të përcaktuar me orar për fillimin e ndeshjes (termini i të cilës ndryshohet).

Nëse shtyrja e ndeshjes bëhet për shkaqe të tjera, atëherë veprohet sipas nenit 18 të Rregullores së Garave.

4.6 Refuzimi për të luajtur dhe situata të ngjajshme- Nëse një ekip i Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës U17 në futbollin e vajzave/grave, pa arsye nuk i zhvillon 2 (dy) ndeshje, gjatë tërë kampionatit (vjeshtë – pranverë) largohet nga garat e mëtejme dhe për të njëjtën aplikohen masat ndëshkuese sipas Rregullores Disiplinore.

4.7 Tërheqja nga garat- Nëse një ekip përjashohet për ndonjë arsye apo tërheqet nga gara për kampionatin e Superligës, Ligës së parë dhe Ligës U17 të vajzave/grave, veprohet sipas nenit 57 të Rregullores Disiplinore.

Neni 5

Ekipet e senioreve dhe kadeteve për vajza/gra, ndeshjet e tyre i zhvillojnë në fushat e regjistruara, licencuara dhe pranuar nga ana e komisionit për infrastrukturë sportive pranë Federatës së Futbollit të Kosovës, poashtu edhe fushat alternative (fushat të cilat përcaktohen nga ekipet nikoqire para fillimit të kampionatit).

Me kërkesë të posaçme të cilën duhet të aprovoj Komisioni i Garave, lihet mundësia e ndryshimit të vendit (fushës) për atë ekip i cili nuk ka mundësi ta zhvilloj ndeshjen në fushën e vet. Por, ai ekip është i obliguar ta përgatitë fushën për lojë dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe sigurimin e ndeshjes.

Ekipi i cili nuk e përgatitë fushën për zhvillimin e ndeshjes (pastrimin nga të reshurat atmosferike, vizatimin me vija të dukshme në fushën e futbollit etj., por kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për përgatitjen e saj atëherë ndeshja shtyhet për 24 orë. Nëse nuk i kanë bërë përgatitjet edhe pas 24 orëve atëherë të njëjtën e humb me rezultat zyrtar).

Neni 6

Garat e Superligës, Ligës së Parë dhe U-17 vajza/gra janë plotësisht të pavarura, zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuar me short. Sikurse në Superligë dhe Ligën e Parë edhe në Ligën U-17 pjesë loja zgjatë 45 minuta apo 2 x 45 minuta me një pushim prej 15 minutave mes dy pjesë lojëve.

Neni 7

Ndeshjet kampionale zhvillohen të shtuneve dhe të dielave apo edhe ndonjë ditë tjetër nëse për këtë vendos Komisioni i Garave.

Klubi nikoqir, për ndeshje të caktuar, mund të propozoj të ndryshojë terminin (nga e shtuna në të dielën apo anasjelltas apo orën e zhvillimit të ndeshjes), me kusht që për këtë të paraqes kërkesë me shkrim (së bashku me arsyetimin përkatës) Komisionit të Garave i cili është i obliguar që të njoftoj edhe klubin kundërshtar, 48 orë para orarit të ri të ndeshjes.

Komisioni i Garave mund të vendos që ndeshja e paraparë për të shtunën apo të dielën të zhvillohet gjatë një dite pune, sipas marrëveshjes me shkrim të të dy klubeve, të prezantuar në Komisionin i Garave së paku 48 orë para zhvillimit të ndeshjes dhe e vërtetuar nga ana e Komisionit të Garave, si dhe nëse nuk ka ankesa nga klubet tjera për atë ndeshje e cila mund të jetë e rëndësishme edhe për plasmanin e ndonjë ekipi tjetër. Marrëveshjet e këtilla, nuk do të pranohen për ndeshjet e tre xhirove të fundit të garave kampionale.

Neni 8

Në interes të rregullsisë së garave, Komisioni Garave me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, mund të vendos që ndeshjet e tre xhirove të fundit të kampionatit të zhvillohen në të njëjtën ditë dhe të njëjtën kohë.

Neni 9

Për kapitujt në vijim dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me gara, vlejné dispozitat e Rregullores së Garave;

- Shtyrja e ndeshjeve,
- Fushat,
- Detyrat e organizatorit të ndeshjes,
- Caktimi i fushës dhe fillimi i ndeshjes,
- Paraqitja e parë dhe identiteti i lojtareve etj...

Neni 10

Të gjitha lojtaret që paraqiten në ndeshje, duhet të kenë valide ID kartelën (kartelën identifikuese) të garave për ndeshje.

Kontrollimin mjekësor, lojtaret e bëjnë dy herë në vit; para fillimit të stinorit vjeshtor gjegjësisht stinorit pranveror të kampionatit, te mjeku specialist i mjekësisë sportive i cili aftësinë e lojtareve e konstaton në raportin zyrtar të dërguar në FFK, para fillimit të stinorit vjeshtor apo pranveror.

Neni 11

Në qoftë se lojtarja paraqitet në ndeshje pa kontrollimin e kryer mjekësor, apo licencim, ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar (3:0) në të mirë të ekipit kundërshtar, nëse nuk është arritur rezultati më i volitshëm për kundërshtarin, kurse ndaj lojtarit dhe klubit do të ngritet procedura disiplinore.

Neni 12

Trajnerët e angazhuar në klube duhet të jenë të pajisur me licencë të vlefshme, të cilët janë të detyruar ta paraqesin (dorëzojnë) në FFK para fillimit të garave, së paku UEFA B të Superliga dhe Liga e Parë vajza/gra, ndërsa për U-17 Licenca C).

Në Superligë klubet në secilën ndeshje kanë për obligim të sigurojnë mjekun (përfshirë klubin nikoqir si dhe atë mysafir).

Në Ligën e parë- Seniore në secilën ndeshje klubet kanë për obligim të sigurojë mjekun (përfshirë klubin nikoqir si dhe atë mysafir).

Në Ligën U-17, në secilën ndeshje klubi nikoqir ka për obligim të sigurojë mjekun (ndërsa klubi mysafir sugjerohet të sigurojë mjekun ose fizioterapeutin i gatshëm për dhënien e ndihmës mjekësore).

Nëse në Superligë dhe Ligën e Parë, klubi nuk posedon as mjekun as fizioterapeutin për dhënien e ndihmës mjekësore, ndeshja nuk mund të zhvillohet, ndërsa ekipi i tillë e humb ndeshjen me rezultat zyrtar.

Në raste të jashtëzakonshme kur për shkaqe të ndryshme as mjeku as fizioterapeuti nuk kanë arritur me kohë në stadium ata mund të priten më se shumti 15 minuta nga koha kur është dashur të zhvillohet ndeshja.

Delegati i ndeshjës duhet të shënojë saktë në protokol arsyen për vonesë ose për mos zhvillim të ndeshjës.

Përfundim bëjnë kategoritë e reja U17 vajzat ku ekipi nikoqir është i obliguar që të ketë mjekun. Sugjerohet fuqishëm që edhe ekipi mysafir ta ketë mjekun apo fizioterapeutin e licencuar.

Nëse ekipi vendas nuk e ka as mjekun e as fizioterapeut e licencuar, atëherë humb ndeshjen me rezultat zyrtar.

Neni 13

Lojtarja e cila e ka të drejtën e paraqitjes për U-17 në kampionatin 2023-2024, konsiderohet lojtarja e cila ka lindur me 01/01/2007 deri në 01.01.2009 (me leje speciale mund aktivizohen lojtaret e lindura në vitin 2010).

Maksimumi i lojtareve nga Liga U-17 vajza (kanë të drejtë të luajnë – aktivizohen edhe në ekipin e senioreve duke përfshirë Superligën, Ligën e Parë) është gjithsej 3 (tre) lojtare, të cilat duhet të pajisen me leje speciale, përkatësisht lojtaret e lindura në vitet 2007 dhe 2008).

Neni 14

Lojtaret Seniore të cilat ndëshkohen me karton të kuq drejtpërdrejt gjobiten në vlerë prej 50 euro (pesëdhjetë euro); ato që marrin karton të kuq pas dy të verdhëve gjobiten me 40 euro, kurse lojtaret nga Liga e U-17 për ndëshkim me karton të kuq drejtpërdrejt gjobiten në vlerë prej 30 euro (tridhjetë euro), ato që marrin karton të kuq pas dy të verdhëve gjobiten me 20 euro.

Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtaret të cilat janë të evidentuara dhe licencuara në Federatën e Futbollit të Kosovës.

Lojtarja nuk mund të luaj në dy ndeshje zyrtare brenda 48h.

IV. HAPËSIRA TEKNIKE

Neni 15

Në hapësirën teknike gjatë zhvillimit të ndeshjës mund të qëndrojnë personat e evidentuar në protokollin zyrtar;

- Lojtaret rezervë (gjithsej 10 veta).
- Kryetrajneri (shefi shtabit teknik).
- Trajneri ndihmës.
- Trajneri i portiereve.
- Mjeku me emblemë – shenjë përkatëse.
- Fizioterapeuti.
- Personi zyrtar i klubit.

Hapësira Restriktive (Brenda rrethojave të fushës)

Neni 16

Mund të qëndrojnë personat e poshtë shënuar;

- Delegati/ja e ndeshjes.
- Vëzhguesi/ja e referimit.
- Fotoreporterët.
- Gazetarët.
- Përfaqësuesi për siguri.
- Mbledhësit e topave.

Neni 17

Në rast se dikush nga personat e lartshënuar nga neni 15 dhe 16 nuk e ka përgatitjen përkatëse; emblemën, shenjën apo ID kartelën, delegati i ndeshjes do të kërkojë nga përfaqësuesi zyrtar apo përgjegjësi për siguri i klubit nikoqir, që personat e tillë të largohen nga fusha (hapësira teknike apo restriktive) jashtë rrethojave të fushës së lojës.

Personat për siguri duhet të jenë nga Policia e Kosovës ose nga sigurimi i licencuar nga MPB. Ekipi vendas duhet të prezantoj kontratën me kompaninë e sigurimit.

Gjatë zhvillimit të ndeshjes duhet të jenë të angazhuar 2 (dy) e më shumë persona të sigurimit (përshirë Superligën dhe Ligën e Parë).

V. DELEGATI I NDESHJES

Neni 18

Listën e delegatëve për çdo ndeshje me propozim të komisionit e shqyrton dhe aprovon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Kurse delegimin e tyre nëpër ndeshje e bënë komisioni që udhëheq me gara.

Delegati-ja, është i/e obliguar që t'i dijë Propozicionet e Garave, aktet tjera normative si dhe detyrat konkrete të tij/saj të cilat janë të përshkruara në;

- Propozicionet e Garave neni 39.
- Rregulloren e Garave neni 21 dhe,
- Udhëzuesin mbi punën e delegatit për ndeshjet zyrtare.

VI. GJYQTARËT

Neni 19

Gjyqtarët i cakton komisioni për delegimin e gjyqtarëve me përgjegjësinë e atij rangu të garave. Inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve të cilët nuk i aplikojnë me përpikëri rregullat e lojës së futbollit apo ato i aplikojnë gabimisht, e bënë Komisioni i vlerësimit.

Ndeshjet kampionale dhe ato të Kup-ës i referojnë gjyqtarët e kualifikuar për atë rang garues. Gjyqtari është i obliguar që para fillimit të ndeshjes të kontrollojë në tërësi fushën se a është apo nuk është e përgatitur – përshtatshme për zhvillimin e ndeshjes.

Lidhur me mosardhjen e gjyqtarëve apo vonesën e tyre në ndeshje duhet vepruar në përputhje me nenin 47 dhe 48 të Propozicioneve të Garave Unike.

VII. NUMRI MË I VOGËL I LOJTAREVE DHE ZËVENDËSIMET E TYRE

Neni 20

Lidhur me numrin e lojtareve dhe zëvendësimet e tyre të veprohet në bazë të neneve; 77, 78, 79 dhe 80, të Propozicioneve të Garave (unike për të gjitha ligat) kurse për zëvendësime aplikohet ndryshimi i përkohshëm;

Zëvendësimet:

Neni 21

Të gjitha ndeshjet e luajtura në konkurrim zyrtarë (meshkuj, vajza/gra) ndeshje kampionale dhe Kup-ës;

21.1 Gjatë ndeshjës secili ekip;

- Mund të përdor një maksimum prej 5 (pesë) zëvendësimeve.
- Ka maksimalisht tre ndalesa zëvendësimi.
- Mund të bëjë zëvendësime në pushim, ndërmjet dy pjesë lojëve (nuk llogaritet si ndalesë zëvendësimi).

21.2 Kur luhet koha shtesë (p.sh. Ndeshjet e Kup-ës) secili ekip;

- Mund të përdor një zëvendësim – shtesë (një të gjashtin, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimeve).
- Ka një ndalesë shtesë zëvendësim (një të katërt, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimit).

21.3 Mund të bëjë zëvendësime shtesë;

- Në periudhën para fillimit të kohës shtesë
- Në periudhën ndërmjet dy kohëve shtesë.
-

Nëse një ekip nuk ka përdorur numrin e tij maksimal të zëvendësimeve ose ndalesave të zëvendësimit, zëvendësimet dhe ndalesat e përdoruara mund të zbatohen në kohën shtesë. Kur të dy ekipet bëjnë një zëvendësim në të njëjtën kohë, kjo do të llogaritet si një mundësi zëvendësimi e përdorur në secilin ekip.

VIII. FANELAT

Neni 22

Ekipet në një ndeshje nuk mund të paraqiten – luajnë me fanela të ngjyrave të njëjta apo të ngjashme. Kompetent për vlerësimin e tyre është gjyqtari kryesor dhe asistentet e tij i cili edhe merr vendimin definitiv.

Nëse ekipet kanë fanelat tradicionale me ngjyra të njëjta atëherë ekipi mysafir është i obliguar që ti ndërroj fanelat në të kundërtën nëse ndeshja nuk zhvillohet për këtë arsye, ajo do të regjistrohet me rezultat zyrtar (parforfe 3:0) në të mirë të ekipit vendas.

Neni 23

Gjatë zhvillimit të ndeshjes lojtaret në pjesën mbrapa të fanelave (në anën e shpinës) të veta duhet t'i kenë numrat e dukshëm të madhësisë sipas dispozitave si në vijim: madhësia – gjatësia e numrave duhet të jetë 20 – 30 cm, kurse gjerësia e vijave të çdo numri duhet të jetë me e vogël së 5 cm.

Numrat e fanelave duhet të përputhen me numrat në regjistrin e lojtareve të shënuara në protokollin e ndeshjes. Në të kundërtën konsiderohet se lojtarja është aktivizuar pa të drejtë loje dhe pasojnë masat sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore.

IX. REGJISTRIMI I NDESHJEVE

Neni 24

Të gjitha ndeshjet (kampionale dhe të Kup-ës) regjistrohen nga ana e Komisionit të Garave në afat prej 3 ditësh nga dita e zhvillimit të ndeshjes së fundit të asaj xhiroje.

Nëse për një ndeshje është ushtruar ankesë, atëherë afati për regjistrimin e ndeshjes do të shtyhet deri në marrjen e vendimit sipas ankesës, gjegjësisht deri në vendimin e plotfuqishëm lidhur me ankesën. Ndeshja e regjistruar nuk mund të anulohet nga i njëjti organ i garave përveç rasteve decive të parapara me Rregulloren e Garave.

Nëse xhirot zhvillohen me dinamikë të përshpejtuar të dielën dhe të mërkurën, afati për regjistrimin e ndeshjeve është dy ditë nga data e zhvillimit të ndeshjes së fundit të asaj xhiroje e domosdo para fillimit të xhiros vijuese, qoftë ajo kampionale apo e Kupës. (përpos kur ka ankesa lidhur me regjistrimin e ndeshjes).

Neni 25

Nëse gjatë kampionatit ekipi largohet nga Komisioni i Garave, për arsye të mos zhvillimit të dy ndeshjeve, atëherë ai ekip fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe për ato që duhet zhvilluar do të veprohet kështu;

- Nëse ekipi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi që ti ketë zhvilluar gjysmën e ndeshjeve apo me pak nga numri përgjithshëm i ndeshjeve të parapara për tërë kampionatin, atëherë të gjitha ndeshjet e zhvilluara të atij ekipi do të anulohen.
- Nëse ekipi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi ti ketë zhvilluar me tepër së gjysmën e numrit të përgjithshëm të ndeshjeve të parapara për atë kampionat, atëherë ndeshjet e tij të zhvilluara deri në atë moment do të regjistrohen me rezultatin e arritur në fushë, ndërsa ndeshjet e mbetura do të regjistrohen me rezultate zyrtare (3:0) në favor të kundërshtarëve të tij të ardhshëm të parapara në kalendar të garave.

Ndeshjet e zhvilluara në kuptimin e këtij neni konsiderohen ndeshjet e zhvilluara në fushë dhe të regjistruara me rezultatet e arritura në fushë apo rezultat zyrtar (në rast të ankesës së aprovuar)

IX. VËRTETIMI I PLASMANIT TË PËRGJITHSHËM (PAS ZHVILLIMIT TË TRE ETAPAVE)

Neni 26

Ekipi i cili e fiton ndeshjen në garat kampionale arkëton 3 pikë, kurse nga ndeshja kur rezultati është i barabartë, secili ekip arkëton nga një pikë;

- Plasmani i ekipeve në tabelë caktohet në bazë të pikëve të fituara. Plasman më të mirë siguron ekipi që ka fituar më shumë pikë.
- Nëse ekipet që kanë plasman të barabartë në tabelë në fund të kampionatit (që garojnë për kreun e tabelës – titullin e kampionatit) daljen në garat ndërkombëtare, largim në rang me të ulët, garojnë për barazh (mbetje dhe hyrje në ligë) apo për ndonjë përfitim tjetër, do të merren për bazë rezultatet dhe golaverazhi në duelet e ndërsjellta.

Nëse edhe në këtë mënyrë nuk mund të vërtetohet plasmani, atëherë zhvillohet ndeshje në mes ekipeve përkatëse me anë të shortit dhe atë;

1. Një ndeshje në fushë neutrale (nëse janë dy ekipe) që i cakton KE i FFK-së, e nëse pas 90 minutave të lojës së rregullt rezultati është i barabartë pasojnë vazhdimet 2 x 15 minuta, e në rast të rezultatit të barabartë pasojnë ekzekutimi penalltive.
2. Nëse janë tri e më shumë ekipe atëherë zhvillohen ndeshje të njëfishta me sistem të pikëve në terren neutral.

Radhitja tabelare gjatë këtyre ndeshjeve përcaktohet në bazë të kritereve të radhitura sipas rëndësisë:

- a) Pikëve të fituara
- b) Golaverazhi
- c) Gola të shënuara
- d) Numri më i vogël i kartonave të kuq
- e) Numri më i vogël i kartonave të verdh
- f) Shorti

Këto kritere vlejnë vetëm për ndeshjet sipas pikës 2 të nenit 26.

Nëse ekipet e theksuara në paragrafit paraprak arrijnë marrëveshje ndërmjet veti, në vend të zhvillimit të këtyre ndeshjeve, çështjen e fituesit mund ta përcaktojnë edhe me short, të cilin do ta udhëheq organi kompetent i garave.

X. KONTROLLIMI MJEKËSOR I LOJTAREVE

Neni 28

Secila lojtare duhet ta kalojë testin mjekësor në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive – QKMS, ku QKMS dërgon raport në emalin zyrtarë të FFK-së, listat e lojtareve me kontrollime mjekësore.

Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor për lojtare zgjatë 6 (gjashtë) muaj. Kontrollimi special mjekësor për lojtaret e reja; U-17 që do të luajnë për ekipin e Parë Senior, vlen 6 muaj (gjashtë) dhe kështu me radhë, për çdo kategori.

Me kontrollimin mjekësor special deri sa ai është në fuqi lojtarja mund të luaj në të gjitha ndeshjet. Klubet janë të obliguara t'i përmbahen në tërësi Rregullores së Garave sa i përket kontrollimit mjekësor dhe personelit mjekësor.

XI. PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 29

Komision Garave i shkallës së parë është i obliguar që në afatin prej tre ditësh e në rast kur kërkohet zgjedhje urgjente edhe me shkurt të shqyrtojë ankesën (nga dita e pranimit të ankesës)

Neni 30

Lojtarja e ndëshkuar me 4 (katër) kartonë të verdhë pushon në xhiron e radhës. Dënimi për shkak të 4 kartonëve të verdhë të shqiptuara në ndeshje kampionale nuk mund të ekzekutohen në ndeshjet e Kupës dhe anasjelltas.

Vuajtja e dënimit, bartet edhe në kampionatin vijues të garave nëse bëhet fjalë për kartonin e kuq drejtpërdrejt, kartonin e kuq pas dy të verdhëve si dhe kartoni katërt i verdhë në ndeshjen e fundit të atij kampionati e i cili ekzekutohet në ndeshjen e parë të kampionatit vijues.

Kartonët tjerë të verdhë shlyhen dhe nuk barten në kampionatin vijues.

Nëse lojtarja e cila ka një karton të verdhë në ndeshjet paraprake të Kupës dhe në ndeshjen e dytë gjysmë finale ndëshkohet me karton të verdhë, i lejohet zhvillimi i ndeshjes finale të Kupës së Republikës së Kosovës.

Dënimi automatik për shkak të kartonit të kuq pas dy të verdhëve në ndeshjen e kupës do të ekzekutohet në ndeshjen e parë të radhës vijuese të Kupës.

Lojtarja e ndëshkuar direkt me karton të kuq, detyrimisht pushon xhiron e radhës qoftë për gara të rregullta qoftë për garat e Kupës.

Lojtarja e ndëshkuar me 4 (katër) kartona të verdhë të U17, pushon automatikisht në xhiron e radhës të U17, në qoftëse lojtarja U17 ndëshkohet me 4 (katër) kartona të verdhë të Senioreve, pushon automatikisht në xhiron e radhës të Senioreve.

Nëse ekipi nikoqir, përfshirë Superligën, Ligën e Parë dhe U-17, nuk paraqitet në fushë ose në të kundërtën ekipi mysafir nuk udhëton në ndeshjen e caktuar sipas orarit zyrtar të ndeshjeve të FFK-së, si dhe mos njoftimi nga ana e tyre për këtë mosparaqitje – mos udhëtim, të njëjtat do të dënohen sipas Rregullores Disiplinore të FFK-së.

XII. SISTEMI I KUPËS

Neni 31

Në garat e KUPËS së Kosovës në futboll – vajzat, ndeshjet kanë sistem eliminimi - sistem i njëfishtë. Pjesëmarrës do të jenë 8 ekipe të Superligës dhe 8 ekipe të Ligës së Parë (gjithesëj 16 ekipe).

Ndeshjet e rrethit të parë përcaktohen me short, ku në një vazo do të futen 16-të ekipet pjesëmarrëse, ku ekipi që do të tërhiqet i pari do të jetë vendas.

Në rrethin e dytë renditen 8 (tetë) ekipet fituese nga rrethi i parë, të cilat futen në short.

Ekipet që mbesin në garë në gjysmëfinale, do të zhvillojnë nga dy ndeshje, dhe atë njëren si nikoqir dhe tjetrën si mysafir (sipas shortit). Në gjysmëfinale ekipi i cili tërhiqet i pari, do të jetë nikoqir në ndeshjen e parë, respektivisht mysafir në të dytën.

Ndeshja finale e Kupës së Kosovës zhvillohet në kryeqytetin e Republikës së Kosovës në Prishtinë.

Garat për KUPË i udhëheq Komisioni unik për SUPERLIGË dhe Ligën e Parë. Organi i cili udhëheq me gara, para çdo xhiroje duhet ta tërheq shortin i cili duhet të jetë publik.

Nëse ndeshja për Kupë përfundon pa fitues, luhet në vazhdime 2 x 15 minuta dhe nëse edhe pas vazhdimeve rezultati është barazi pason ekzekutimi i penalltive sipas rregullave të lojës, për përcaktimin e fituesit.

Ngjashëm veprohet edhe për gjysmëfinale, kur zhvillohen nga dy ndeshje dhe nëse rezultati është plotësisht identik në dy ndeshjet.

Në ndeshjen finale për Kupën e Kosovës, nëse përfundon pa fitues, atëherë për ta përcaktuar fituesin do të zhvillohen vazhdimet 2 x 15 minuta.

Nëse edhe pas vazhdimet nuk përcaktohet fituesi, pason ekzekutimi i penalltive sipas rregullave të lojës.

Nëse një ekip nuk paraqitet pa arsye në fushë për ta zhvilluar ndeshjen për KUP, atëherë ai ekip do të eliminohet nga garat e mëtutjeshme.

Lojtarja në Kup-ën e Kosovës mund të aktivizohet me më shumë se 1 (një) ekip gjatë një stinori futbollistik.

XIII. BULENTINI ZYRTAR

Neni 32

Të gjitha vendimet e komisionit të garave shpallen në Ueb-faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës si dhe në "Buletinin Zyrtar" të FFK-së.

Të gjitha klubet garuese janë të obliguara që ti përfillin vendimet nga Ueb-faqja zyrtare e FFK-së dhe të "Buletinit Zyrtar".

XIV. AFATI KALIMTAR

Neni 33

Afati kalimtar i lojtareve që dëshirojnë të kalojnë nga një klub në tjetrin këtë mund ta bëjnë gjatë;

- Afatit kalimtar dimëror i cili nuk guxon të jetë më i shkurtër së 4 javë dhe,
- Afatit të rregullt kalimtar veror i cili nuk guxon të jetë më i shkurtër së 8 javë.

Datat e sakta për afatet kalimtare të lojtareve i cakton KE - FFK-së, me vendim të posaçëm që e merr në kohën e duhur, bazuar në afatet e sugjeruara dhe ato obligative të FIFA

XV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 34

Çdo vendim që merret në përputhje me këto Propozicione si dhe me ato unike është obligativ për të gjithë, derisa dispozitat e këtyre Propozicioneve të mos ndryshojnë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve i bënë KE - FFK-së , në procedurë të njëjtë si për aprovimin e tyre.

Neni 35

Për çështjet që nuk janë përfshirë në këto Propozicione, vlejnjë Propozicionet unike për të gjitha rangjet dhe ligat, Rregullorja e Garave, Rregullorja Disiplinore si dhe aktet tjera normative të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Neni 36

Këto Propozicione hyjnë në fuqi më datë 18 Gusht 2023.

Prishtinë, 18 Gusht 2023

**Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së,
Agim Ademi**